



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KRUJE

## A N A L I Z Ë

### E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2018 TË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR KRUJË

DREJTUAR :  
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM  
Znj.Arta Marku

T I R A N Ë

**E nderuar Znj. Prokurore e Përgjithshme!**

Në mbyllje të vitit 2018 në zbatim të detyrimeve ligjore qe rrjedhin nga Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë“u paraqes këtë material, në të cilin përcaktohen arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe analizohen treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prokuror.

Kjo analizë është bazuar në drejtimet dhe përparësitë tona në luftën kundër kriminalitetit dhe ka për qëllim përgjithësimin e përvojës pozitive, por njëkohësisht edhe evidentimin e mangësive dhe problemeve që kanë lindur gjatë këtij viti gjyqësor me synimin e vetëm përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve dhe goditjen në kohë dhe me efikasitet të veprave kriminale në territorin e Rrethit Gjyqësor, në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj.

Në qendër të vëmendjes tonë gjatë vitit që analizojmë kanë qenë zbatimi me rigorozitet i Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave *“Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018”*, zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së dt. 20.09.2018 *“Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2017”* të Kuvendit të Shqipërisë të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm si dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të dala në funksion të tyre.

Ne kete kuader rendesi e veçantë u është kushtuar çështjeve më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi që janë veprat penale **kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike**, veprat penale **kundër rendit dhe sigurisë publike** ku prioritet kanë qenë veprat penale në fushën e **narkotikëve dhe ato që lidhen me prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve luftarake dhe municionit, kryesisht të lëndëve plasëse**, veprat penale në fushën e **veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë**, veprat penale **kundër fëmijeve, martesës dhe familjes, veprat penale kundër mjedisit etj.**

Duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm, për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti duke u dhene perparësi hetimeve proaktive ne veprat penale ne fushen e korrupsionit te zyrtareve te shtetit ne nivel vendor dhe ne veçanti ne hetimin e veprave penale ne fushen e narkotikeve te cilat ne rrethin tone rezultojne me perhapje jo te vogel. Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kruje jane perdorur metodat speciale te hetimit ne 29 procedime penale dhe rezultatet kane qene te mira. Per 12 procedime kane perfunduar hetimet nderkohe qe jane duke u hetuar edhe 17 procedime te tjere.

Po keshtu jane bere perpjekje per te rritur nivelin e perfaqesimit te akuzes në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve si dhe për të bashkërenduar punën me të gjithë aktoret e tjere të luftes kunder kriminalitetit perfshi ketu Policine e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese. Rendesi i është kushtuar edhe permbushjes se detyrimeve lidhur me mardheniet juridiksionale me autoritetet e huaja ne fushen e zbatimit te leterporosive, ekstradimeve, njohjes se vendimeve penale te huaja etj.

Krahas kësaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin procedural penal jemi përpjekur që në veprimtarinë tonë të respektojmë të gjitha kërkesat e një procesi të rregullt ligjor si ndaj personave të dyshuar si autorë të veprave penale duke u garantuar të gjitha të drejtat që iu njeh ligji dhe duke ndërhyrë në të gjitha rastet kur të drejtat e tyre janë cënuar nga organe të tjera edhe ndaj viktimave te ketyre veprave duke u dhene prioritet shtresave me vunerabel te shoqerise si te miturve, grave apo personave qe nuk kane mundesi per tu mbrojtur.

Për veprat penale të rënda me ndjeshmëri të madhe në opinionin publik e shoqëror te permendura me siper kemi bërë përpjekje serioze që hetimet t'i përfundojmë shpejt e me cilësi, duke zbatuar një politikë ndëshkimi në përputhje me rëndësinë e faktit dhe efektet për parandalimin e tyre me qëllimin e vetëm për të garantuar një jetë të sigurtë dhe me sa më pak probleme për komunitetin.

Rendesi e veçante i është kushtuar implementimit ne praktike te Udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem. Ne kete kuader vemendja është perqendruar sidomos tek Udhezimi Nr. 06 dt. 20.11.2018 “ Per hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve te vepres penale” . Per lehtesimin e zbatimit te ketij Udhezimi Drejtuesi i Prokurorise ka nxjerre edhe nje Udhezim te brendshem ku jane percaktuar detyrat konkrete per prokuroret, oficeret e policise gjyqesore dhe personelin tjeter te Prokurorise ne funksion te ketij zbatimi. Jane evidentuar te gjitha çështjet penale te hetuara gjate vitit 2018 te parashikuara ne nenin 7 te ketij Udhezimi dhe per te gjitha çështjet e perfunduara jane pergatitur 9 fashikuj per ti derguar ne Prokurorine e Krimeve te renda nderkohe qe jane udhezuar prokuroret qe per çështjet ne hetim te kryejne detyrimisht verifikimin pasuror dhe ne te gjitha rastet qe do te rezultojne pasuri te vena nga aktiviteti kriminal te vleresohet kryerja e sekuestrimeve sipas percaktimeve te K.Pr.Penale dhe aktet se bashku me relacionin spjegues te dergohen ne Seksionin e Posacem te Prokurorise per Krime te Renda per te vazhduar hetimet.

Duhet pranuar se rezultatet e arritura deri tani ne kete drejtim nuk kane qene ato te deshiruara. Perverc punes se pamjaftueshme te strukturave te policise gjyqesore qe operojne ne kete fushe mendojme se duhet rritur edhe pergjegjesia e prokuroreve qe hetojne keto vepra penale duke rritur kontrollin gjate fazes se hetimeve paraprake per te sjelle rezultatet e deshiruara. Aktualisht kemi ne hetim 20 procedime per vepren penale te parashikuar nga neni 283/1,2 te K.Penal dhe 12 procedime per vepren penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Do te bejme te gjitha perpjekjet qe hetimi i ketyre çështjeve te kryhet i plote dhe me profesionalizem per te arritur objektivat e kerkuara.

Gjate ketij viti qe po analizojme ka vazhduar implementimi i ligjeve te reja ne kuadrin e Reformes ne Drejtesi te cilat kane sjelle shume ndryshime ne aktivitetin procedural te Organit te Prokurorise. Ne kete kuader jane bere perpjekje serioze per te garantuar pavaresine e prokuroreve ne vendimarrje dhe jane ndertuar raporte te reja ndermjet tyre dhe drejtuesit te Prokurorise. Po keshtu rendesi e veçante i është kushtuar zbatimit ne praktike te risive te reja qe solli ndryshimi i K.Pr.Penale. Gjate ketij viti është shtuar numeri i procedimeve penale qe jane derguar ne Gjykate per tu zgjidhur me mareveshje, gjithesej 34 procedime penale nga te cilet vetem ne 2 raste Gjykata ka refuzuar mareveshjen nderkohe qe është aplikuar urdheri penal per 3 çështje.

Gjatë këtij viti të cilin po analizojmë kjo Zyrë ka ushtruar ndjekjen penale për 747 procedime nga 647 të vitit 2017 si dhe për 429 (266+163) persona të pandehur dhe nën hetim nga 409 te vitit 2017. Nga sa shihet ka nje rritje te konsiderueshme te numerit te çështjeve penale te regjistruara e reflektuar kjo edhe ne numerin e personave te proceduar.


Në një këndvështrim të përgjithshëm shihet qartë se veprat penale më të përhapura gjatë këtij viti kanë qenë krimet kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike gjithsej 300 procedime ku numrin me te madh e zene ato te parashikuara nga neni 134 i K.Penal ( vjedhje pasurise) 115 procedime, , ( veprat penale qe cenojne regjimin juridik te tokes dhe te ndertimeve)100 procedime, neni 150-162 (shkaterrimi prones) 28 procedime, neni 143 i Kodit

Penal (mashtimi) 6 procedime, **veprat penale kunder rendit dhe sigurise publike** gjithesej 280 procedime nga te cilat 88 procedime per “Kultivim te bimeve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, 21 procedime per “Prodhim dhe shitje te narkotikeve” , parashikuar nga neni 283 i K.Penal, 37 procedime per “Shkelje te rregullave te qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i K.Penal, 22 procedime per vepren penale “Drejtimi automjeteve ne menyre te parregullt “ parashikuar nga neni 291 i K.Penal, 21 procedime per nenin 278 te K.Penal, 10 procedime per nenin 275 te K.Penal, 5 procedime per nenin 277 te K.Penal dhe 7 procedime per nenin 287 te K.Penal, **krimet kunder jetes dhe shendetit** 90 procedime, **veprat penale kunder drejtesise** gjithesej 39 procedime , **krimet kunder veprimtarise shteterore** gjithesej 27 procedime ku numerin me te madh e zene ato te parashikuara nga neni 248 i K.Penal ( Shperdorimi i detyres ) 25 procedime, etj.


Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike përhapja e veprave penale në rrethin e Krujës gjatë vitit 2018 dhe krahasimin e tyre me vitin 2017 për të parë me mirë tendencat për çdo grup vepre penale.

## Sipas veprave penale

- krimet kunder pasuris dhe sferes ekonomike(300)
- Veper penale kunder rendit dhe sigurise publike (280Procedime)
- Krime kunder jetes dhe shendetit (90 Procedime)
- Veper penale kunder drejtesise(39 Procedime)
- Veper penale kunder autoritetit te shtetit (27 Procedime)
- Te tjera (11 Procedime)




Veprat penale krahasuar me vitin 2017 :



Konkretisht, figurat e veprave penale më të përhapura janë si më poshtë:

## Sipas Neneve

■ Neni 284 I K.Penal ( 88 Procedime)	■ Neni 283 I K.Penal ( 21 Procedime)
■ Neni 290 I K.Penal ( 37 Procedime)	■ Neni 291 I K.Penal ( 22 Procedime)
■ Neni 278 I K.Penal ( 21 Procedime)	■ Neni 248 I K.Penal ( 27 Procedime)
■ Neni 134 I K.Penal ( 115 Procedime)	■ Neni 130/a I K.Penal ( 29 Procedime)
■ Neni 150-152 I K.Penal ( 28 Procedime)	■ Nene te tjera (359 Procedime)



Hetimet e kryera për këto kategori veprash penale tregojnë se shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të mosfunksionimit të organeve të qeverisjes vendore dhe organizmave të tjere ligjzbatues, probleme të infrastrukturës dhe

edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesit e mjeteve, por edhe nga shtetasit, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit, etj. Po kështu edhe kontigjenti i personave që kanë kryer këto vepra penale rezultojnë të jete kryesisht i moshës 18-60 vjeç me nivel të ulët arsimor dhe kulturor, kryesisht banorë të Njesive Administrative të fshatrave përreth qytetit të Fushe-Krujes dhe në Malesinë e Krujes. Numri i personave me arsim të lartë të dyshuar apo të akuzuar si autorë të veprave penale është i ulët dhe kryesisht janë punonjës të administratës vendore që janë akuzuar për vepra penale në lidhje me detyrën e tyre.

**Në regjistrat** e kësaj prokurorie janë regjistruar për **vitin 2018** gjithsej **747** procedime penale me **429** persona të pandehur dhe nën hetim prej të cilëve **83** kanë qenë me masë sigurimi "Arrest në burg".

**Nga viti 2017** janë mbartur gjithsej **182** procedime penale me **84** persona të pandehur nga të cilët **26** të pandehur kanë qenë me masë sigurimi "Arrest në burg".


### **NË TOTAL:**

**Në vitin 2018** duke përfshirë edhe çështjet e mbartura është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **905** procedime penale me **526** persona të pandehur dhe nën hetim, ndër të cilët **98** kanë qenë me masë sigurimi "Arrest në burg", ndërsa pjesa tjetër janë ndjekur me masa të tjera sigurimi.

Për periudhën 2 vjeçare 2017-2018 janë regjistruar gjithsej 1394 procedime penale me 838 persona të pandehur dhe nën hetim nga të cilat janë dërguar për gjykim 525 procedime me 600 të pandehur.

Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2018 dhe 2017, sipas mënyrës së përfundimit:





**Për vitin 2018** është vendosur mosfillimi për **267** materiale kallezues dhe janë në fazë verifikimi 20 materiale të tjera .Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret mbasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në ligj. Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit kryesisht mjekoligjore etj, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë.

**Nga procedimet penale të mosfilluara** janë ankimuar në Gjykatë **14** prej tyre. Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit në **7** raste dhe **2** raste janë shfuqizuar. Rastet e tjera janë ende në gjykim.

**Gjatë vitit 2018** janë transferuar **18** procedime penale me **14** të pandehur/persona nën hetim nga të cilët **5** kanë qene me masë sigurimi “arrest në burg”. Kryesisht procedimet penale të transferuara janë derguar në Prokurorinë Pranë Gjykeses së Shkallës së Parë Tiranë , Seksionit për të Mitur, dhe pjesa tjetër në Prokurorinë për Krime të Renda dhe në rrethe për shkak të kompetencës tokësore.

## HETIMI PARAPRAK

Për vitin 2018 treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve të kryera ndaj shtetasve të dyshuar si autorë të veprave penale të ndryshme paraqiten si me poshtë:

Janë arrestuar në flagrancë nga Policia Gjyqësore 108 persona.

Është nxjerrë urdhër ndalimi nga Prokurori për 3 shtetas.

Për 1 person të arrestuar në flagrancë apo të ndaluar nga Policia Gjyqësore, Prokurori ka disponuar me urdhër për lirim të menjëhershëm. Në Gjykatë janë dërguar për vleftësimin e arrestit apo të ndalimit 110 persona dhe Gjykata i ka vlerësuar te ligjshme te gjitha kerkesat e prokurorit.

Për këta tregues është kërkuar respektimi me korrektesë i kriterëve të përcaktuara në ligjin procedural penal si dhe garantimi i të drejtave të personave që u është hequr liria duke kushtuar një kujdes të veçantë sidomos për respektimin e garancive që u siguron ligji personave të mitur. Në analizën e treguesve bie në sy fakti se te gjitha kerkesat e paraqitura nga prokurori janë vlerësuar te ligjshme nga Gjykata e Shkallës së Parë. Kjo tregon se konsultimi paraparak i oficereve te policise gjyqesore qe kryejne arrestet dhe ndalimet me prokuroret e gatshem qe tashme është nje norme ne aktivitetin tone ka dhene rezulttatet e deshiruara.

Prokuroret kane kerkuar caktimin e e mases se sigurimit “ arrest në burg” për 76 persona ndërsa nga Gjykata është caktuar kjo masë vetëm për 72 persona. Përveç sa sipër ne 5 raste është kërkuar nga prokurori caktimi i kesaj mase per persona te dyshuar si autore te veprave penale qe i jane shmangur hetimit kerkesa te cilat jane pranuar edhe nga Gjykata.

## PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

Janë pushuar gjatë kësaj periudhe kohore 139 çështje nga 110 te vitit 2017 ose 29 çështje me shumë se ne vitin 2017. Nga keto :

✚ 38 procedime jane pushuar për mungesë të faktit penal dhe të elementëve të veprës penale.

✚ 2 procedime për mungesë të provave të mjaftueshme.

✚ 99 procedime për shkaqe të tjera procedurale.

Është pushuar ndjekja penale për 48 persona (në këtë numër përfshihen si të pandehurit ashtu edhe personat ndaj të cilëve janë kryer hetime duke qenë se statusi procedural i tyre është i njëjtë). 6 (gjashte) nga personat per te cilet jane pushuar hetimet kane qene me mase sigurimi “Arrest Burg”.

Çështjet e pushuara zënë rreth 21 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën 1 vjeçare (në këtë llogaritje nuk përfshihen çështjet e transferuara dhe çështjet e pushuara per shkak te parashkrimit ).

**Numri** më i madh i çështjeve të pushuara sic shihet është “për shkaqe të tjera procedurale”, gjithsej **99** çështje ndër të cilat vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij. Gjate ketij viti jane pushuar per efekt te afateve te parashkrimit edhe **6** çështje penale.

Çështjet e pushuara për mungesë të provave, janë gjithsej **2** çështje. Duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale, gjithsej **38** çështje, arrihet ne konkluzionin se është e nevojshme qe gjate fazes per verifikimin paraprak te materialeve kallezuese duhet bere nje vlerësim sa me i drejtë i fakteve të paraqitura në keto materiale per te shmangur regjistrimin e procedimeve kur nuk është i nevojshem.

**Në vitin 2018** jane ankimuar ne gjykate **10** vendime pushimi. Është pranuar ankimi ne te **2** raste. Ne **3** raste Gjykata ka lene ne fuqi vendimin e pushimit. Rastet e tjera jane ne gjykim.

Ne numerin e pergjithshem te pushimeve jane te perfshira vendimet e pushimit dhe rastet e kerkesave per pushim ne gjykate gjithesej **83** kerkesa nga te cilat per **19** çështje është pranuar kerkesa, ne **5** raste është vendosur kthimi akteve dhe vazhdimi i hetimeve kurse per nje rast është vendosur kthimi i akteve dhe formulim i akuzes, dhe te tjerat jane ne proces gjykimi.

## **PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA**

**Gjatë vitit 2018** janë pezulluar **229** procedime penale ose **34%** e çështjeve të përfunduara , krahasuar kjo me vitin 2017 ku numeri i çështjeve te pezulluara ka qene **227** te tilla. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë procedimet për veprën penale të “Vjedhjes” (neni 134 i K.Penal) dhe te kultivimit te bimeve narkotike kjo per shkak te kultivimit te ketyre bimeve ne toka pa pronar por edhe per pune te pamjaftueshme nga strukturat e shtetit per identifikimin e parcelave ku kultivohen keto bime , perfshi ketu policine dhe organet e pushtetit vendor. Gjithesesi ajo qe konstatohet kete vit per vepren penale te parashikuar nga neni 284 i K.Penal është fakti se megjithese numeri i procedimeve ka qene me i madh se ne vitin 2017 numeri i pergjithshem i bimeve te kultivuara ka qene shume me i vogel cka tregon se strategjia e kultivuesve ka ndryshuar duke perdorur parcela te vogla, me numer te vogel bimesh ne vende te fshehta kryesisht larg qendrave te banuara ne mal ose ne pyje gje qe kerkon nje mobilizim me te madh nga organet ligjzbatuese per kontrollin e territorit dhe parandalimin ne kohe te perhapjes se kesaj vepre penale.

## **ÇËSHTJET ME TË MITUR**

Ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Kruje është ngritur Seksioni për të Mitur i cili ka në përberje të tij një prokuror dhe një oficer të Policisë Gjyqësore por duhet theksuar se ky Seksion nuk mund të funksionojë normalisht për tju pershtatur kërkesave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe kjo jo vetëm për shkak të levizjes së Prokuroreve por edhe për mungesë të koordinatorit të asistencës për subjektet me status të posaçëm. Gjithësesi nga ky seksion për vitin 2018 janë trajtuar gjithësej **12** procedime, me **14** të pandehur të mitur. Nga këto për **3** çështje është vendosur pushimi, **1** çështje është dërguar për gjykim nderkohe që vazhdon hetimi për çështjet e tjera.

### **PROCEDIMET E DËRGUARA PËR GJYKIM**

**Në vitin 2018** janë dërguar për gjykim **275** procedime penale, **25** çështje me shumë se vitin e kaluar, me **348** të pandehur nga të cilët **73** të arrestuar dhe pjesa tjetër të ndjekur me masa të tjera sigurimi. Procedimet penale të dërguara për gjykim zënë rreth **42.7%** të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara.

Nga kërkesat e dërguara për gjykim **34** raste i perkasin gjyqimit me mareveshje dhe **3** raste urdherit penal.

**Gjatë vitit 2018 kemi vetëm një rast të kallzuar nga ILDKP-ja**, dhe konkretisht bëhet fjalë për procedimin penal nr.299 viti 2018, të regjistruar për nent 257/a-2 dhe 287 me të pandehur shtetasin N.N, dërguar me kërkesë për gjykim më datën 28.12.2018.

Nderkohe nuk kemi të regjistruar asnjë procedim penal mbi bazën e kallezimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit apo Sektorit të Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme mbasi nga këto Institucione nuk është referuar asnjë rast i tillë në këtë Prokurori. Në një masë të madhe procedimet penale janë regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit, pjesa tjetër nga kallezimet e qytetareve direkt në Prokurori dhe në dy raste është vendosur regjistrimi i procedimit mbi bazën e materialeve të bera publike nga mediat e shkruara dhe vizive.

#### **Në TOTAL në vitin 2018 :**

**Janë përfunduar 661** procedime me **441 (348+93)** persona të pandehur/ nën hetim nga të cilët **78** të arrestuar.

**Kanë mbetur në hetim 270** procedime penale me **85** autorë, dhe **21** të arrestuar. Këtë vit rezulton të jenë mbartur **88** procedime me shumë se vitin e kaluar dhe kjo gjë lidhet me mungesat në organike të prokuroreve ( dy me pak se organika e miratuar ).

**Objektivi** ynë për çështjet e mbartura është që të përfundojnë brenda tremujorit të parë të vitit 2019.

Është me vend të përmendim se gjatë këtij viti janë konstatuar edhe zgjatje të panevojshme të afatit të hetimit për procedime të caktuara për shkaqe subjektive, pra, për moskryerje të detyrave nga oficerët e policisë gjyqësore dhe mungesë kontrolli nga

prokurorët e çështjeve. Fakti që janë zgjatur afatet e hetimeve mbi **tre muaj** për **53** procedime nga 77 ne vitin 2017), me **41** të pandehur ose persona nën hetim tregon se kërkohet më shumë vëmendje, më shumë kontroll nga prokurorët e çështjeve, por edhe nga drejtuesi i prokurorisë për të eliminuar zvarritjet dhe për të zgjidhur çështjet brenda afatave procedurale.

**Treguesit** e punës për secilin prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë si më poshtë:

<b>Prokurori</b>	<b>Procedime penale të përfunduara</b>	<b>Dërguar në gjyq</b>	<b>Pushuar</b>	<b>Pezulluar</b>	<b>Shpallur moskompetenca</b>	<b>Mbartur</b>
Petrit Çano	9	2	2	4	1	1
Bujar Memia	290	115	71	100	4	91
Bujar Cici	45	11	10	23	1	-
Florian Bonjaku	71	30	12	24	5	76
Mirela Kapo	219	92	43	78	6	57
Astrit Halilaj	<b>27</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	-	<b>1</b>	45
<b>Totali</b>	661	275	139	229	18	270

Është për tu theksuar se prokurori Bujar Memia ka qene i ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale detyre te cilen e ka kryer me korrektese.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Arjan Resnja:**

Ka përfunduar gjithsej **81** procedime, nga të cilat:

**13** janë referuar për pushim procedimi.

**62** janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.

**6** jane referuar për pezullim te hetimeve

**29** procedim mbeten në hetim.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Rexhep Derveni:**

Ka perfunduar gjithsej **120** procedime, nga të cilat:

**28** janë referuar për pushim procedimi.

**74** janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq .

**13** janë referuar për pezullim.

**5** janë referuar për transferim.

**44** procedime mbeten në hetim.

**Oficeri i Policisë Gjyqësore Anila Dusha:**

Ka përfunduar gjithsej **166** procedime, nga të cilat:

**49** janë referuar për pushim procedimi.

70 janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.

38 janë referuar për pezullim.

9 procedime mbeten në hetim

## GJYKIMI

Për vitin 2018 ka përfunduar gjykimi për 250 procedime me 290 të pandehur nga të cilët 62 të arrestuar. Kanë mbetur të mbartura në gjykim 62 procedime penale.

Nga këto 8 procedime janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë krahasuar me 2 raste ne vitin 2017

Për 229 procedime është zhvilluar gjykim i shkurtuar.



Për 21 procedime është zhvilluar gjykim i zakonshëm, nga te cilet 6 jane gjykuar ne mungese.

Nga prokurori është kërkuar dënimi me burgim për 91 të pandehur dhe nga Gjykata është caktuar dënimi me burgim për 82 të pandehur.

Për 43 të pandehur prokurori ka kërkuar dënimin me gjobë dhe nga gjykata janë dhënë dënime me gjobë për 41 të pandehur.

Ndërsa nga 117 kërkesa të prokurorit për pezullim të egzekutimit të vendimit Gjykata ka dhënë këtë lloj dënimi për 133 te tilla.

Më poshtë paraqiten grafikisht llojet e dënimeve të kërkuara nga prokurorët dhe mënyra se si ka vendosur gjykata.



**Për vitin 2018** janë dhene nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë tre pafajesi e te plota ose 1.2% të çështjeve të gjykuara. Një rast është për nenin 145 të K.Penal, një rast tjetër për nenin 242,25 të K.Penal dhe rasti i tretë për veprën penale “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i K.Penal. Për të tre rastet Prokurori ka ushtruar ankim

**Gjykata** ka vendosur pushimin e procedimit gjatë gjykimit për 2 çështje.

**Prokurori** ka kërkuar **2** raste terheqje aktesh dhe gjykata ka vendosur në **5** raste kthimin e akteve.

**Për fazën** e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

**Për veprat** penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, veprat penale në fushën e narkotikëve, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë synuar në parandalimin dhe ndëshkimin e këtyre veprave penale. Gjithsesi, po ti referohemi faktit rezulton se veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike dhe ato kundër jete dhe shëndetit kanë pësuar rritje në krahasim me një vit më parë cka do të thote se prokurorët duhet të rishohim qëndrimin e tyre në gjykate për keto kategori veprash duke e bërë më fleksibël dhe duke e përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në rrethin tonë.

**Gjatë vitit 2018** në Gjykatën Administrative të Apelit ka përfunduar gjykimi për dy kërkesa për kompensim për burgim të padrejtë dhe janë në gjykim edhe 3 ( tre ) raste të tjera.

**Gjatë vitit 2018** kanë qenë **14** rastet kur prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës: në **3** raste pafajësisë të çështjes dhe **11** për ndryshim akuze apo për lloj dhe masë dënimi.

Nga rastet e ankimuar në **4** raste ankimi është pranuar dhe rastet e tjera janë në gjykim.

**Është ushtruar** e drejta e ankimit edhe kundër vendimeve për masat e sigurimit në **2** raste nga prokurori të cilat nuk janë pranuar nga Gjykata. Në **14** raste kanë ushtruar të drejtën e apelit të pandehurit dhe Gjykata ka rrefuzuar kërkesën e tyre në **11** raste.

### **EGZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE**

**Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë** gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e egzekutimit të vendimeve penale. Prokurori **Bujar Memia** i ngarkuar me këtë detyrë ka urdhëruar egzekutimin e **214** vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

**Prej tyre:**

**Janë nxjerrë 80** urdhëra për egzekutimin e vendimeve me burgim nga të cilët janë egzekutuar 74 urdhëra.

**Janë nxjerrë 40** urdhëra për egzekutimin e vendimeve me gjobë nga të cilët janë egzekutuar vetëm 29 urdhëra.

**Janë nxjerrë 62+32=94** urdhëra për dënimet alternative të cilët rezultojnë të jenë egzekutuar 78 urdhëra.

**Janë ekzekutuar gjithsej 181 urdhëra për ekzekutim.**

**Ngelen pa u ekzekutuar gjithsej 33 urdhëra për ekzekutim.**

**Gjithashtu** janë kryer edhe detyrimet e tjera që lidhen me ankimet e palëve në Gjykatë gjatë fazës së egzekutimeve. Problem mbetet ende egzekutimi i dënimeve me gjobë, kjo



kryesisht për shkaqe objektive (pamundësinë e pagimit të tyre nga personat e dënuar), por në ndonjë rast edhe për moskryerje të detyrës nga organet përmbarimore.

Po kështu gjate këtij viti janë shqyrtuar edhe 145 kërkesa të dënuarve për lirim parakohe me kusht, qëndrim në shtëpi, lirim për shkak semundje etj nga të cilat janë pranuar 3 kërkesa, dhe pjesa tjetër është vendosur rrëzim kërkesë dhe një pjesë janë në gjykim.

### **MARRDHENJET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA**

Jane egzekutuar 2 leterporosi nga jashtë shtetit. Kemi dy raste njohje vendimi penal të huaj dhe një rast ekstradimi për jashtë shtetit. Po kështu është shpallur në kerkim nderkombetar një person dhe është anuluar kerkimi për tre të tjerë.

### **VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE**

**Gjatë vitit 2018** në veprimtarinë administrative të organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë janë reflektuar ndryshimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë” dhe ligjeve të tjera në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Në këtë kuadër është kërkuar zbatimi i Regullores “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë pranë gjykatës së shkalles së parë Krujë” në të cilën janë përcaktuar në mënyrë specifike detyrat e çdo punonjësi të administratës. Me urdhera të brendshëm të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë mbi bazën e udhëzimeve të dërguara nga Prokurori i Përgjithshëm është vendosur norma për administrimin e regjistrave, për shpërndarjen e çështjeve nepermjet shortit, për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori, për të unifikuar praktiken e ndjekur nga prokurorët për realizimin e pergjimit, rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të pergjimit, për trajtimin e materialeve të klasifikuara nga personat që e kanë këtë akses dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga K.Pr.Penale por edhe nga Udhëzimi nr.05 dt. 26.10.2018 i Prokurorit të Përgjithshëm “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”. Për këtë të fundit është e nevojshme garantimi i burimeve njerëzore dhe financiare të cilat deri tani kanë munguar.

Po kështu ka vijuar puna për kryerjen e detyrave në përputhje me ligjin organik dhe Udhëzimin e Përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm me Ministrin e Brendshëm për funksionimin e Policisë Gjyqësore. Nga përvoja e deritanishme rezulton se me gjithë përpjekjet ka akoma pengesa në mirëfunksionimin e këtij organi. Kjo lidhet me transferimet e shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore që ka ndikuar në cilësinë dhe shpejtësinë e hetimeve si dhe vonesa të akteve të ekspertimit të cilat kanë sjelle zvarritje të hetimeve. Gjithsesi referuar vitit të kaluar situata këtë vit ka qenë më e përmirësuar dhe falë kontakteve të ngushta që janë vendosur mes drejtuesve të dy organeve shpresojmë që këto mangësi të minimizohen.

Kete vit është realizuar nje bashkëpunim më i mirë me Zyrat Rajonale të Drejtorisë së Policisë Durrës veçanërisht ne Zyren Kunder Narkotikeve dhe rezultatet e arritura kane qene shume me te mira nderkohe qe nuk është punuar me te njejtin ritem nga Zyra kunder krimin ekonomik dhe kjo ka sjelle si pasoje zvarritjen e hetimeve per disa raste per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale". Aktualisht nje Urdhërese e Drejtorit te Pergithshem te Policise se Shtetit kete kategori veprash penale e ka deleguar per tu kryer ne Komisaritet e Policise . Duke pasur parasysh kapacitetet njerezore por edhe cilesine e oficerëve te policise gjyqesore ne Komisaritet jemi te mendimit se kjo metode nuk do te jete funksionale dhe nuk do te permiresoje cilesine e hetimit per kete grup veprash penale te cilat jane edhe prioritete e i organeve tona.

**Gjatë vitit 2018** është treguar kujdes per te trajtuar me seriozitet shqetësimet e ngritura nga palët në proces apo qytetarët është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Gjate ketij viti nuk rezulton qe ndaj prokuroreve apo oficerëve te policise gjyqesore te jete marre ndonje mase disiplinore apo perfshirje te tyre ne veprimtari te paligjshme.

**Është** me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, kryesekretari, sekretaret ,punonjesja e pastrimit dhe shoferi, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë. Per vitin 2018 jane shpenzuar ne total ne llogarine 602 – 10.697.339 leke. Nder to vendin e zene shpenzimet honorare ne vleren 6.068.240 leke dhe shpenzimet per sigurine dhe ruajtjen fizike te objektit te Prokurorisë ne vlere 3.532.126 leke Diferenca është shpenzuar per pagesat e ujit dhe te energjise elektrike, shërbime per materiale zyre dhe transporti etj. Detyrimet e prapambetura jane pasqyruar ne bilancin e vitit 2018 dhe kapin vleren 3.515.172 leke Mbi 90 % e ketyre te fundit jane likuidime te pakryera per Insitutin e Mjekesise Ligjore. Jane shlyer te gjitha detyrimet financiare per vitin 2018. Për të gjitha rastet e gadishmërisë dhe mbikohës së punës të cilat janë evidentuar në menyrë të plotë dhe kapin shifren 452.511 leke, punonjësit e kësaj Prokurorie janë paguar.

Vlen te theksohet se kete ngarkese pune Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kruje e ka perballuar pjesen me te madhe te vitit me dy prokurore + drejtuesin cka ka sjelle edhe zvarritje te hetimeve per çështje te veçanta. E njejte paraqitet gjendje edhe sot. Sic shihet edhe nga kjo analize nga vitit ne vit numer i çështjeve vjen duke u rritur nderkohe qe numer i prokuroreve zvogelohet gje qe padyshim do te kete ndikimin e vet ne cilesine e punes qe kryhet.

**Nga analiza** në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, për të ardhmen prioritete tona kryesore do të jenë:

1. Implementimi me sukses i gjithë ndryshimeve ne K.Penal dhe K.Pr.Penale duke duke i dhene perparësi pavaresise se prokuroreve ne vendimarrje por edhe aplikimit te instituteve te reja te parashikuara ne keto Kode.

2. Përfundimi ne nje kohe sa me te shkurter i të gjitha çështjeve të mbartura nga viti **2017**.
3. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale ne fushen e kultivimit te bimeve narkotike me objektiv goditjen e tyre ne kohe cka do te sjelle minimizimin e ketij fenomeni ,veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kunder jetës, shëndetit, veprave penale te kallezuara nga ILDKPI, Kontroll i Larte i Shtetit dhe Sektori i Verifikimit te Integritetit te Personave te Zgjedhur ne Prokurorine e Pergjithshme, veprat penale kunder femijeve, marteses dhe familjes me objekt te veçante veprat penale kunder dhunes ne familje , veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, në veçanti shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor dhe çdo lloj forme tjetër të krimit që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.
4. Trajtim rigoroz i çështjeve me autore dhe viktima te Mitur duke u dhene perparesi interesit me te larte te tyre , duke respektuar te gjitha rregullat e parashikuara ne Kodin e Drejtesise Penale per te Mitur dhe duke zbatuaar nje politike ndjekje penale dhe denimi qe ti sherbeje edukimit dhe integritit te tyre ne shoqeri.
5. Rritja e numerit te hetimeve proaktive dhe perdorimit te teknikave speciale te hetimit , kryerja e hetimeve sistematike pasurore per te gjitha rastet e parashikuara ne ligj me synim sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive me burime kriminale.
6. Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme dhe kete kuader forcimi i bashkëpunimit me Policine Gjyqesore dhe organet e tjera ligjzbatuese me qëllim për të mos lejuar askënd t'i shpetojë ndëshkimit ligjor për veprat e kryera.
7. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
8. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë ne perputhje me Ligjin nr.97/2016 “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republken e Shqiperise”, si dhe “Rregullores Standarte te Organizimit dhe Funksionimit te Prokurorive te Juridiksionit te Pergjithshem” për tu pershtatur me ndryshimet e ketj ligji me synimin per t’ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, forcimit te diplines se brendshme dhe te vullnetit per te identifikuar cdo lloj problematike brenda organit dhe per ta goditur ate perpara se te ndodhe.
9. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, rekomandimeve te Keshillit te Ministrave per luften kunder kriminalitet dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ne kete drejtim.

10. Rritja e profesionalizmit të prokurorëve kjo nepermjet ndjekjes se trainimeve vazhduese ne Shkollen e Magjistratures si dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi per te perfaqesuar ne menyre dinjitoze Institucionin ne raport me publikun, brenda dhe jashte orarit te punes.

**DREJTUESI I PROKURORISË**  
**PETRIT ÇANO**